


**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
**Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority**



**Vendimi Nr.99/2024**

**Datë: 20.11.2024**

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas Shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit në mbledhjen e datës, 20.11.2024 mori këtë:

### V E N D I M

I, Lejohet Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me marrjen e kontrollit të drejtpërdrejtë dhe blerjen e 100% të aksioneve të PULMED klinikë ambulatore për sëmundjet e mushkërive dhe alergjitë, nga Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o.;

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 24.09.2024, me Nr. Prot. 637/24-01/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me marrjen kontrollit të drejtpërdrejtë dhe blerjen 100% të aksioneve të PULMED klinikë ambulatore për sëmundjet e mushkërive dhe alergjitë, nga Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o..

### Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e dorëzuar, me datë: 24.10.2024;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së, me datë: 25.10.2024;
3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 21 Gusht 2024.

A.B.J

SGZ

## **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro;
3. Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve.

**Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o. ("DC BLED")**, e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me seli në Pod Skalo 4, 4260 Bled, Slloveni, me numër regjistrimi: 5690366000 e cila është ndërmarrje sllovene, aktive në tregun privat të kujdesit shëndetësor, si qendra e parë private diagnostike në Slloveni, me aktivitet kryesor, në fushën e gastroenterologjisë. Kjo ndërmarrje është themeluar më 1992, si qendra e parë private diagnostike në Slloveni. Objekti dhe lloji i aktiviteteve janë zgjeruar ndërkohë. Sot DC BLED, u ofron pacientëve shërbime shëndetësore në këto fusha: gastroenterologji, urologji, kardiologji, ortopedi, diagnostikim me rreze X dhe ultratinguj, alergologji, tirologji, dermatologji, gjinekologji, otorinolaringologji, konsulencë ushqimore etj. Kjo ndërmarrje, ofron shërbime rehabilitime, përmes aplikimit të programeve të fizioterapisë. Njësitë operuese, DC BLED i ka në Lublanë, Novom Mestu dhe Bled. E njëjta operon në kuadër të grupit të shoqërive Sava dhe Triglav.

**PULMED** është një institucion mjekësor privat që ofron shërbime mjekësore, në fushat e pulmologjisë, pneumologjisë dhe alergologjisë. E njëjta është e regjistruar dhe operon në Republikën e Sllovenisë, ndërsa nuk është aktive dhe nuk ka filiale në Republikën e Kosovës. I përket subjekteve të vegjël juridikë, pasi që ka 3-4 punonjës dhe nuk ka filiale, e as nuk zotëron më shumë se 5% të aksioneve në ndonjë shoqëri.

### **Tregu përkatës:**

**Tregu i produktit:** Tregu për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor (privat).

**Tregu gjeografik:** Në transaksionin e propozuar është tregu ndërkombëtar, përfshirë dhe Republikën e Kosovës.

**Analiza e Konkurrencës:** Transaksioni i propozuar nuk paraqet ndonjë shqetësim për konkurrencën në tregun përkatës, pasi palët nuk kanë synim të operojnë në Kosovë, por operojnë në Republikën e Sllovenisë. Transaksioni nuk rezulton në mbivendosje horizontale apo marrëdhënie vertikale ndërmjet aktiviteteve të palëve, duke eliminuar kështu çdo shqetësim të mundshëm për konkurrencën. Përqendrimi në fjalë paraqet mundësi të vlefshme, për zgjerim të gamës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor të disponueshme në DC Bled Group. Transaksioni do ketë efekte të shumta pozitive në fushën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, në tregun e kujdesit shëndetësor të Republikës së Sllovenisë, respektivisht në lokacionin ku ndodhet institucionin shëndetësor PULMED. Transaksioni nuk do ndikojë në territorin e Kosovës, pasi që asnjëra nga palët në përqendrim nuk janë të pranishme në Kosovë, përmes filialeve.

## Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizua

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëra palë në transaksion, bën pjesë në grupin e shoqërive Sava (Sava RE), me shoqëri mëmë Pozavarovalnica Sava, d.d.. Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësime për konkurrencën dhe nuk pritet të ndikojë në konkurrencën në Kosovë. Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion/blerja nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

### Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Propozim Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

## AUTORITETI I KONKURENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare



Kaltrina Sela  
Nënkryetare

Nafije Osdautaj,  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi-Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva